

# KONTRA(TË RINJT) CEPSION

A kanë të rinjtë në Maqedoni qasje në kontracepsion modern?

**K**ontracepsioni modern është një nga aspektet më të rëndësishme të shëndetit reprodktiv dhe seksual, veçanërisht në mesin e të rinjve. Edhe pse, disa strategji nacionale (Strategjia nacionale për shëndet seksual dhe reprodktiv dhe Strategjia nacionale për amësi të sigurt) ofrojnë kontracepsion falas, kjo akoma nuk është përmbushur. Si rezultat i kësaj, shkalla e shfrytëzimit të kontracepsionit modern në Republikën e Maqedonisë është më e ulët në rajon. Hulumtimet multiindikatorë i kryer nga UNICEF tregojnë se 8,2% të femrave në moshë prej 15 deri në 19 vjet shfrytëzojnë ndonjë mjet modern kontraceptiv, 8,3% të femrave në moshë prej 20 deri në 24 ndërsa nga moshë 25 deri në moshën 29 11,4%. Sipas këtij hulumtimi vetëm 1,3% shfrytëzojnë pilula (kontracepsion oral hormonal).

Këto të dhëna, tregojnë qartë se ka nevojë për ndërmarrje të masave konkrete nga institucionet kompetente që të zgjidhet kjo çështje, gjegjësisht që të rritet numri i femrave që shfrytëzojnë kontracepsion modern.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të tregohen të gjitha faktet dhe gjendjet në lidhje me shfrytëzimin e kontracepsionit modern në mesin e të rinjve dhe nevojën për ndërmarrjen e masave nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht nga Ministria për shëndetësi dhe nga Fondi për sigurim shëndetësor.


## PSE KA RËNDËSI KONTRACEPSIONI NË MESIN E TË RINJVE?

Një nga çështjet më të rëndësishme, në lidhje me shëndetin seksual dhe reprodutiv është edhe kontracepsioni (modern). Dobitë nga shfrytëzimi i kontracepsioneve janë shumë të rëndësishme:

- Kontracepsioni e parandalon shtatzëninë e paplanifikuar
- Shfrytëzimi i kontracepsionit ka dobi të ndryshme mjekësore<sup>1</sup> siç është zvogëlimi i rrezikut nga kanceri i qafës së mitrës, kancerit ovarial, sëmundjet inflamatore të pelvikut, mbrojtja nga cista vezore, anemi e shkaktuar nga mungesë të hekurit, i ulë dhimbjet menstruale, probleme me gjakderdhje menstruale, dhimbjet gjatë ovulimit, rritja e qimeve në trup dhe në fytyrë, simptome të vezëve policistik, simptome të endrometriozes.
- Shumë studime tregojnë se femrat të cilat e planifikojnë shtatzëninë (dhe shfrytëzojnë kontracepsion) kanë shëndet më të mirë në përgjithësi, janë më mirë të arsimuar, statusi i tyre është më i mirë në kuadër të familjes, por edhe në shoqërinë, por janë edhe ekonomikisht më produktiv<sup>2</sup>.
- Para se të gjithash, kontracepsioni paraqet të drejtë për shëndet dhe mbrojtje shëndetësore (në vitin 2012 Kombet e Bashkuara, respektivisht Fondi për popullsi të Kombeve të Bashkuara në raportin vjetor<sup>3</sup> e deklaroi qasjen në kontracepsione për të drejtë universale njerëzore).



**Ndryshimi në shfrytëzimin e kontracepsioneve nga femrat e reja në mes të dy hulumtimeve**



## ÇFARË ËSHTË GJENDJA NË MAQEDONI?

Në Republikën e Maqedonisë nuk ekzistojnë të dhëna të vazhdueshme të cilat do ti tregojnë trendet në nivel vjetor në lidhje me shfrytëzimin e kontracepsionit modern. Dy raportet dhe hulumtimet më të rëndësishme në lidhje me këtë çështje janë:

- Gjendja e popullsisë botërore (UNFPA) dhe
- Hulumtimi multiindikator klaster (UNICEF)

Përmes këtyre raporteve dhe hulumtimeve mund të fitojmë të dhëna për shfrytëzimin e kontracepsioneve në mesin e të rinjve, por edhe në mesin e popullsisë në përgjithësi, krahas kësaj mund të krahasohen gjendjet në shtetet tjera të botës.

Nga hulumtimi i multiindikatorëve nga viti 2005-2006<sup>4</sup> edhe nga viti 2011<sup>5</sup> mund të përfundohet se nuk ka ndryshime të rëndësishme në lidhje me shfrytëzimin e kontracepsionit tek tre grup moshat në të cilat bëjnë femrat të reja (siceshtetreguarnegrafikonin 1). Kjo do të thotë se në periudhën prej 6 viteve në Maqedoni nuk janë ndërmarrë masa (ose masat e ndërmarrë nuk kanë pasur efekt) që të ndryshohet kjo gjendje, respektivisht që të rritet shfrytëzimi i kontracepsionit.

Sipas raportit për popullatën botërore nga viti 2011<sup>6</sup>, përqindja e femrave në Maqedoni që janë në periudhë reprodutivë dhe shfrytëzojnë kontracepsion modern është shumë larg nga shtetet fqinjësore, por edhe më gjerë në Evropë. (shihgrafikonin 2)

Gjendja në tregun për kontracepsionet orale hormonale në Republikën e Maqedonisë tregon se ato janë prezent. Në vendin tonë janë të regjistruar 5 kontracepsione orale dhe 1 urgjente.

Çmimi i pilulave janë të ndryshme<sup>7</sup>, lëvizin nga 2 euro deri në 10 euro. Çmimi është një nga faktorët kryesor që ndikojnë mbi shfrytëzimin e kontracepsioneve tek femrat e reja<sup>8</sup>.

<sup>1</sup> World Health Organization Department of Reproductive Health and Research (WHO/RHR) and Johns Hopkins Bloomberg School of Public Health/Center for Communication Programs (CCP), INFO Project. Family Planning: A Global Handbook for Providers. Baltimore and Geneva: CCP and WHO, 2007, p. 3.

<sup>2</sup> UNFPA (2012) State of World Population 2012, New York, UNFPA, p. ii.

<sup>3</sup> UNFPA (2012) Annual Report 2012 – Promises to keep. New York, UNFPA, p. 8.


<sup>4</sup> State Statistical Office of Macedonia, (2007), Multiple Cluster Indicator Survey 2005-2006, State Statistical Office of Macedonia, Skopje

<sup>5</sup> MULTIPLE indikatorë clustersurvey(2011) Ministria e shëndetësisë : Ministria për arsim dhe shkencë : Ministria për punë dhe politik sociale, Shkup

<sup>6</sup> UNFPA, (2011), State of World Population, New York, UNFPA

Përqindja e përdorimit të kontracepsionit (metoda moderne ose ndonjë tjetër metod) në shtetet evropiane sipas raportit të UNFPA - Gjendja e popullatës botërore në vitin 2011

Grafikon 2



## EKZISTOJNË DOKUMENTE STRATEGJIKE, POR NUK ZBATOHEN

Disa vite me radhë, në Republikën e Maqedonisë kanë filluar proceset që nënkuptojnë krijim të politikave për përmirësimin e shëndetit seksual dhe reprodutiv të qytetarëve të Maqedonisë. Këto politika përgatiten me pjesëmarrjen e palëve të ndryshme, në proces konsultativ, me përdorimin e praktikave më të mira ndërkombëtare. Megjithatë, këto politika nuk zbatohen, sidomos në pjesën për qasje drejtë mjeteve kontraceptive, me që efektet nga ky moszbatim reflektohen edhe mbi shkallën e shfrytëzimit të kontracepsioneve.

Në Strategjinë nacionale për shëndet seksual dhe reprodutiv<sup>7</sup> një nga sferat strategjike është planifikimi i familjes dhe kontracepsioni. Me këtë Strategji parashikohet sigurim falas i kontracepsioneve për grupet e rrezikuara sociale dhe sigurim të "kontracepsionit urgjent". Në ndërkohë, këto arritje vlerësohen me tregues të qartë, respektivisht me zbatimin e këtyre masave do të arrihet: 40% të femrave në periudhën reprodutiv të shfrytëzojnë kontracepsion, si edhe zgjerim të listës pozitive të barnave me 3 lloje të mjeteve kontraceptive.

Përveç kësaj strategjie dhe Strategjia për shtatzëni të sigurt<sup>10</sup> parashikon masa që kanë të bëjnë me ritjen e shfrytëzimit të kontracepsionit. Këto dy strategji nacionale shumë qartë i përcaktojnë drejtimet për përmirësimin e shëndetit seksual dhe reprodutiv të popullatës, duke i përfshirë edhe të rinjtë. Këto qëllime do të përmbushen edhe me sigurimin e kontracepsioneve që duhet të jenë në dispozicion.

## MODELE TË NDRYSHME NË EVROPË PËR SIGURIM TË KONTRACEPSIONIT

Çmimi i mjeteve kontraceptive paraqet pengesë, sidomos për të rinjtë. Çmimet e mjeteve kontraceptive në tregun tonë arrijnë deri në 10, respektivisht deri në 12 euro. Kjo vlerë në nivel mujor është shumë e lartë për shumicën e personave të rinj.

Andaj që të bëhet mjetet kontraceptive më të qasura, shtete të ndryshme në Evropë e menaxhojnë këtë çështje në mënyra të ndryshme në kuadër të sistemeve të tyre shëndetësore. Një pjesë të shteteve evropiane e rregullojnë këtë me kompensim të kostove për blerjen e kontracepsioneve. Këto janë disa shembuj nga shtete të ndryshme!



Gjermania

**<18**

Kompensim të plotë të mjeteve për kontraceptiv të përshkruara me recent

---



Holandë

**<21**



Francë

**15-18**

Kompensim i pjesërishtëm të kostove të kontracepsioneve të përshkruara me recept

Kompensim i plotë përmes sigurimit obligues shëndetësor me kufi maksimale prej 350 euro

Kontracepsion urgjent, pílula prej gjeneratës së parë dhe të dytë, implane dhe spirale janë krejtësisht falas

---

Të gjithë qytetarët në Rumanj, që janë të siguruar në kuadër të sistemit të sigurimit shtetëror shëndetësor, janë të obliguar të japin kontribute në fondin nacional për mbrojtje shëndetësore. Ata që japin kontribute ose janë të liruar nga participimi i fillë mund t'i marrin falas kontracepsionet hormonale dhe spiralet. Rumania gjithashtu ka edhe program nacional për mbrojtje shëndetësor të fëmijëve dhe grave, e cila ofron prezervativë dhe kontracepsione hormonale falas për kategoritë më të rrezikuara, në kuadër të qendrave për planifikim të familjes. Këtu bëjnë pjesë ata që jetojnë në zonat rurale, të papunësuarit, personat që marrin ndihmë sociale dhe fëmijët në arsim.



Rumani<sup>12</sup>

<sup>7</sup> Intervistë përmes telefonit nga barnatore në Shkup [26.07.2013]

<sup>8</sup> HERA (2011) Faktorë të cilat ndikojnë në shfrytëzimin e kontracepsionit në Republikën e Maqedonisë, Shkup, HERA, fq. 7.

<sup>9</sup> Ministria e shëndetësisë (2010) Strategji për shëndetësi seksuale dhe reprodutiv në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020, me Plan të veprimit deri në vitin 2013, Shkup.

<sup>10</sup> Ministria e shëndetësisë (2010) Strategji për amësi të sigurt në Republikën e Maqedonisë për periudhën 2010 – 2015 me Plan të veprimit, Shkup.

<sup>11</sup> International Planned Parenthood Federation European Network (2013) Barometer on Women's Access to Modern Contraception Choice, Brussels, p. 21.


<sup>12</sup> HERA (2011) Faktorë të cilat ndikojnë mbi shfrytëzimin e kontracepsioneve në Republikën e Maqedonisë, Shkup, HERA, fq. 7.

# REKOMANDIME

Të drejtat seksuale dhe riprodutive të personave të rinj në Maqednoi janë të garantuar me një varg dokumente ndërkombëtare të cilat Republika e Maqedonisë i ka nënshkruar dhe ratifikuar. Gjatë viteve të kaluar, në vendin tonë është shënuar një përparim në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodktiv. Megjithatë, një nga sferat ku nuk ka (ose nuk është i rëndësishëm) progres është shfrytëzimi i kontracepsionit modern. Duke e marrë parasysh dobinë nga shfrytëzimin e kontracepsionit për vet individin, por edhe për shoqërinë në përgjithësi, nevojiten hapa dhe masa përkatëse.

Për përmirësim, respektivisht për rritje e shfrytëzimit të kontracepsionit nevojitet:

- Zbatim të plotë të Strategjisë nacionale për shëndet dhe të drejta seksuale dhe riprodutive dhe të Strategjisë nacionale për shtatzëni të sigurt, përfshirë edhe qasjen në kontracepsione
- Përfshirje të së paku tre mjete kontraceptive në listën e barnave të cilat i mbulon Fondi për sigurim shëndetësor
- Sigurim të kontracepsionit falas për grupet sociale dhe të rrezikuara
- Përfshirje e të rinjve në procesin e vendimmarrjes për zbatimin e këtyre masave



X. E. P. A.

Осудженио за здравствено калушор и истрокувало

A Member Association of



**IPPF** International  
Planned Parenthood  
Federation

European Network